



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS**  
**DREJTORIA E ZHVILLIMIT RURAL DHE TURIZMIT**  
**Sektori i Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave**

Nr. 13 prot.

Vau Dejës, më 24.022021

**RELACION**

**Për dhënien në përdorim me kontratë qiraje të fondit kullosor (Pyje qe kulloten) për kullotjen e bagëtime të imta.**

**Drejtuar : Këshillit Bashkiak Vau i Dejës**

**Të nderuar këshilltarë,**

Administrimi i fondit pyjor dhe kullosor në territorin e Bashkisë Vau u Dejës, është një ndër funksionet e Bashkisë, i përcaktuar në nenin 27 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ku në piken 5 të këtij neni përcaktohet: **Funksionet e Bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit:** Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve:pika 5. *Administrimin e fondit pyjor dhe kullosor publik, sipas legjislacionit në fuqi.*

Ligji bazë mbi të cilin kryhet administrimi i fondit kullosor është ligji nr. 9693/2007 “Për fondin kullosor “ i ndryshuar”, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Bazuar në Ligjin nr 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”,neni 9 pika 1.2 c , neni 54 pika e (l) neni 18 pika 2 është kompetencë e Këshillit të Bashkisë ,tjetërsimi apo dhënia me qira të tretëve të pronave të Bashkisë.

Në zbatim të neneve 15 dhe 17 të ligjit nr. 9693/2007 “Për fondin kullosor “ i ndryshuar” ka dalë Udhëzimi i Ministrit të Mjedisit nr. 2 datë 20.07.2016 “Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari”.

**Nga verifikimi në vend , rezulton që sipërfaqja e kërkuar ndodhet në ekonomine pyjore gomsiqe ngastra nr. 21/a ,numri i pronesise 331 fshati gomsiqe .Sipërfaqja totale e ngastrës është 35.35 ha dhe ajo e dobishme për kullotje 31 ha. Sipërfaqja që kerkohet të merret në përdorim është 31(një) ha.**

Dokumentacioni i paraqitur është konform kreut 2 pika 4 dhe 5 të Udhëzimit nr 2 datë 20.07.2016 “Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari”,dhe përbëhet nga:

a) Kërkesa për marrjen në përdorim të sipërfaqes kullimore për kullotje.

c) Projekt permirsim kollote

d) Çertifikaten veterinare

e) Vertetimin nga njesia administrative për vendbanimin dhe numrin e baktive për kullotje.

Sipas kërkesës së paraqitur sipërfaqja kullimore propozohet të jepet për një afat 10 vjeçar bazuar në udhëzimin nr 2 kreu II pika 7 germa b.

Bazuar ne udhezimin nr 2 pika 4,4.1“Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari”siperfaqja e kerkuar ndodhet ne krahinen malore veriore ne lartesi nen 600m e cila klasifikohet si kullote dimerore.

**Në funksion të sipërfaqes që merret në përdorim, sipas VKM 632, “Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje e kositje bari”pika 1,germa a tarifohet si me poshte.**

Nr.	Lloji i bagëtive	Numri i bagëtive	Dimerore leke/krere pyje qe kulloten	Vlera totale
1	Dhi	50	100	5000
	Gjithsejt	50	100	5000

**Vlera totale e pagesës/vit është 5000 lekë (pese mije) leke.**

**Bazuar në sa më sipër, propozojmë miratimin e dhënies në përdorim me qera të sipërfaqes prej 31 ha ne Ekonomine pyjore gomsiqe,ngastra nr 21/a me kapacitet kullisor 50 krere të imta(dhi) për një afat 10 vjecar.**

**Bashkëlidhur po ju dergojmë.**

**1.Hartën e ekonomise pyjore gomsiqe në shkalle 1: 25000.**

**2.Kontraten tip për dhënien në përdorim të fondit kullosor për miratim sipas Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit nr. 2 datë 20.07.2016 kreu II pika 12.**

Duke ju falënderuar, ju ftojme në miratimin e projekt vendimit


**PËR DREJTORINE E PYJEVE, TURIZMIT KULTURES DHE MJEDISIT**

Ing.Mark Suli



**Specialistet**

Ing.Zeqir Ujka



Miratoi

Drejtori

Rrok Ftoni

